UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"
PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
http://www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Rektori i përkohshëm
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 168
Dt 25.02.2015

Në mbështetje të nenit 49 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Përkohshëm duke vendosur lidhur me kërkesat dhe statusin e studentëve të FGJT dhe FSHA, në mbledhjen e mbajtur më 16.2.2015, mori:

Vendim

1. Lejohet transferimi i studentëve nga Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Universitetit të Prishtinës në Fakultetin e Gjeoshkencave, Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike të Universitetit të Mitrovicës.
2. Studentët e transferuar do të futen në programin e SEMS-it të Universitetit të Mitrovicës dhe në këtë mënyrë kalojnë nga studimet me index në studime me ID kartë.
3. Në bazë të këtij vendimi, Fakultetet përkatëse do të lëshojnë vendime individuale për secilin nga studentët e transferuar, të cilat do të bëhen pjesë përbërëse e dosjes së secilit student.
4. Vendimi zbatohet edhe për studentët e nivelit master të këtyre fakulteteve.
5. Në bazë të vendimit të lëshuar, verifikimin lidhur me transferimin e notave do ta bëjnë prodekanët e njësive akademike të UMIB-it.

Arsyetim

Universiteti i Mitrovicës është në vitin e dytë të ekzistimit dhe të regjistrimit të studentëve në kuadër të tri fakulteteve teknike (FGJ, FTU dhe FIMK) kurse dy njësitë akademike të UP-së në Mitrovicë FGJT dhe FSHA janë duke e zhvilluar vitin e fundit të studimeve të rregullta në nivelin bachelor dhe master. Andaj, në pamundësi për të vazhduar studimet në kuadër të njësive akademike FGJT dhe FSHA të UP-së, Senati i Universitetit lejon transferimin e studentëve në programet përkatëse të fakulteteve teknike të Universitetit të Mitrovicës. Studentëve të lejuar për transferim do tu mundësohet futja në programin e SEMS-it të UMIB-it nga studimet me indeks në studime me ID kartë. Senati i Universitetit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve teknike të UMIB-it;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. Sektorit të IT-së së UMIB-it;
5. Zyrtarit ligjor.

Prof. asoc. dr. Alush Musaj
Rektor i përkohshëm

UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727
http/www.umib.net

Rektor i përkohshëm
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 172/03
Dt 25.02.2015

Në bazë të nenit 153 pika 1, nenit 154 dhe nenit 159 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Përkohshëm, në mbledhjen e mbajtur më 16.2.2015, mori:

VENDIM

I. Refuzohet si e pabazë ankesa e m.sc. Vaide Kqikut, me nr. 880 të datës 09.10.2014, e paraqitur kundër raportit të Komisionit vlerësues për zgjedhjen e stafit akademik të datës 18.9.2014, e shpallur në ueb-faqen zyrtare të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

II. Vërtetohet në tërësi raporti i Komisionit vlerësues për zgjedhjen e kandidates Fatbardha Hoxha në pozitën "Asistente për grup lëndësh Gjuhë Shqipe" në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini".

Arsyetim

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 16.2.2015, pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit të plotë të kandidates Vaide Kqiku, u pajtua plotësisht me propozimin e Komisionit recensues, sepse mosha e kandidates në momentin e aplikimit është 31 vjeç, gjë që është në kundërshtim me nenin 159 të Statutit të UMIB-it, dhe se nuk ka dëshmi për notën mesatare të studimeve bachelor, ndërsa kandidatja e përzgjedhur Fatbardha Hoxha i përmbush të gjitha kriteret në bazë të Statutit të UMIB-it. Në bazë të kësaj që u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, MASHT-it.

Vendimi t'i dërgohet:
1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurës;
3. Zyrtarit ligjor.

Rektor i përkohshëm
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727
http/www.umib.net

Rektor i përkohshëm
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 173/03
Dt 25.02.2015

Në bazë të nenit 153 pika 1, nenit 154 dhe nenit 159 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Përkohshëm, në mbledhjen e mbajtur më 16.2.2015, mori:

VENDIM

I. Refuzohet si e pabazë ankesa e m.sc. Hysni Jasharit, me nr. 778 të datës 01.10.2014, e paraqitur kundër raportit të Komisionit vlerësues për zgjedhjen e stafit akademik të datës 29.8.2014, e shpallur në ueb-faqen zyrtare të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

II. Vërtetohet në tërësi raporti i Komisionit vlerësues për zgjedhjen e kandidates Blerina Voca në pozitën "Asistente për grup lëndësh në Makineri Industriale" në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini".

Arsyetim

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 16.2.2015, pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit të plotë të kandidatit Hysni Jasharit, u pajtua plotësisht me propozimin e Komisionit recensues, sepse mosha e kandidatit në momentin e aplikimit është mbi 30 vjeç (viti i lindjes 1977) dhe se notën mesatare të studimeve bachelor e ka 7.29, gjë që është në kundërshtim me nenin 159 të Statutit të UMIB-it, ndërsa kandidatja e përzgjedhur Blerina Voca i përmbush të gjitha kriteret në bazë të Statutit të UMIB-it. Në bazë të kësaj që u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, MASHT-it.

Vendimi t'i dërgohet:
1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Zyrtarit ligjor.

Rektor i përkohshëm
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

UNIVERSITETI I MITROVICËS • UNIVERSITY OF MITROVICA • ISA BOLETINI •

UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i përkohshëm
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 174/03
Dt 25.02.2015

Në bazë të nenit 153 pika 1, nenit 154 dhe nenit 157 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Përkohshëm, në mbledhjen e mbajtur më 16.2.2015, mori:

VENDIM

1. **Dr. sc. Nazmi Hasi** zgjidhet **profesor asistent** për lëndët: **Fizika I** dhe **Fizika II,** në Fakultetin e Gjeoshkencave.
2. Zgjedhja e të përmendurit është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 157 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit.
3. I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statutit të Përkohshëm të Universitetit.
4. Zgjedhja zgjat për periudhën 4 (katër) vjeçare.
5. Të përmendurit i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhura personale të UMIB-it.
6. Kontrata e punës me të përmendurin do të lidhet nga data **16.2.2015**.

Arsyetim

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: **Fizika I** dhe **Fizika II,** në Fakultetin e Gjeoshkencave.

Këshilli i Fakultetit e ka rishqyrtuar raportin e Komisionit recensues dhe i ka propozuar Senatit të Universitetit që dr. sc. Nazmi Hasi të zgjidhet profesor asistent për lëndët e sipërpërmendura.

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 16.2.2015, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit recensues dhe të Këshillit të Fakultetit të Gjeoshkecave, vendosi që dr. sc. Nazmi Hasi të zgjidhet profesor asistent për lëndët Fizika I dhe Fizika II, në Fakultetin e Gjeoshkencave.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Senatit të Universitetit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrtarit për paga;
5. Zyrtarit ligjor.

Rektor i përkohshëm

Prof. asoc. dr. Alush Musaj

UNIVERSITETI I MITROVICËS • UNIVERSITY OF MITROVICA • ISA BOLETINI

UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727
http/www.umib.net

Rektor i përkohshëm
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 175/03
Dt 25-02-2015

Në bazë të nenit 153 pika 1, nenit 154 dhe nenit 157 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Përkohshëm, në mbledhjen e mbajtur më 16.2.2015, mori:

VENDIM

I. Refuzohet si e pabazë ankesa e Ardian Gojanit me nr. 981 të datës 14.10.2014, e paraqitur kundër raportit të Komisionit vlerësues për zgjedhjen e stafit akademik të datës 19.9.2014, i shpallur në ueb-faqen zyrtare të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

II. Vërtetohet në tërësi raporti i Komisionit vlerësues për zgjedhjen e kandidatit Nazmi Hasi në pozitën "Mësimdhënës për lëndët Fizika I dhe Fizika II" në Fakultetin e Gjeoshkencave të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Arsyetim

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 16.2.2015, pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit të plotë të kandidatit Ardian Gojani, u pajtua plotësisht me propozimin e Komisionit vlerësues, sepse i përmenduri nuk i ka plotësuar kushtet e parapara me konkurs, pasi i ka munguar nostrifikimi i diplomës së masterit dhe doktoratës nga MASHT-i, ndërsa kandidati i përzgjedhur Nazmi Hasi i ka përmbushur të gjitha kushtet e parapara me konkurs, si dhe zgjedhja e tij është bërë në pajtim të plotë me Statutin e UMIB-it. Në bazë të kësaj që u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, MASHT-it.

Vendimi t'i dërgohet:
1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Zyrtarit ligjor.

Rektor i përkohshëm
Prof. asoc. dr. Alush Musaj